

Pozicioni: Menaxher I Dyqanit Globe

Detyrat/Pergjegjesite

- Menaxhimi i përditshem i dyqanit dhe mbajtja e përgjegjesisë së plotë për mbarëvajtjen e të gjitha punëve në përputhje me politikat dhe standartet e vendosura nga Kompania.
- Punon në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e shitjeve, maksimizimin e fitimeve duke arritur targetin e miratuar nga Shoqëria.
- Është përgjegjës direkt për arritjen e objektivave të dyqanit duke bërë të mundur menaxhimin dhe motivimin e stafit të dyqanit që të rrisin shitjet ditore dhe të maksimizojnë efikasitetin në punë.
- Përbush dhe garanton të gjitha detyrat në lidhje me planifikimin, organizimin, zbatimin dhe kontrollin e objektivave mujore, javore e ditore për të gjithë punonjësit që janë nën përgjegjësinë e tij.
- Vendos prioritete, identifikon dhe zgjidh problemet urgjente që lidhen me mbarëvajtjen e dyqanit.
- Sigurohet që stafi të jetë i trajnuar dhe përgatitur për të kryer të gjitha proceset e punës të nevojshme gjatë një dite pune.

Kriteret

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë, preferohet Menaxhim Biznesi.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi.
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze (njohja e një gjuhe tjetër përpos gjuhës angleze përbën avantazh).
- Eksperiencë në Menaxhim për të paktën 2 vite
- Të ketë aftësi organizative.
- Person energjik, me iniciativë, këmbëngules dhe i vetëmotivuar.
- Të ketë njohuri në përdorimin e programeve bazë kompjuterike. Të ketë aftësi për të punuar në Grup.